



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____._____.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Blerje materiale elektrike për ndriçimin e qytetit, Bashkia Kurbin”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
31681410-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,496,698 (dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kurbin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 ”Për prokurimin publik”, Neni 83:

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 49,934 (dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

c. Formulari i ofertes sipas Shtojces 1 dhe Shtojces 2

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, cdo operator ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të ofertës së tij edhe formularin e ofertës sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 2 të Dokumenteve Standarte të Tenderit.

d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Njësia e Prokurimit e ka hartuar këtë kriter duke u bazuar në pikën 7, gërma”a”, neni 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se operatorit ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 7 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të

paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2021-2022), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se 30%** e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qene lloji i procedures eshte ”Procedurë e hapur e thjeshtuar”, përcaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa ”c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:..... b) 40% te vlerës se përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetary..... ”;*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2023 (sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin 9632/2006 ” Për sistemin e taksave vendore ”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (furnizimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për furnizime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej **minimalisht 3 (tre) persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, e vertetuar kjo me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për të paktën muaj e fundit të deklaruar.

- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, për te pakten muaj e fundit te deklaruar.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te disponoje 1 (një) mjet transporti mallrash mbi 1.5 ton, i cili do të shërbejë për te bere te mundur levrimin e produkteve të ofertuara në ambientet e AK, ne pronesi te tij ose te marra me qera.

Për mjetin e marrë me qera nga një person juridik apo fizik tjetër, ofertuesi duhet ta shoqërojë me:

- Kontrate te lidhur perpara Noterit,
- Certifikaten e pronesise,
- lejen e qarkullimit,
- kontrolli teknik SGS (i vlefshem)
- taksat e paguara (të vlefshme)
- siguracioni, (i vlefshem).

Për mjetin në pronësi te paraqiten:

- Certifikata e pronesise,
- leje e qarkullimit,
- kontrolli teknik SGS (i vlefshem)
- taksat e paguara (të vlefshme)
- siguracioni (i vlefshem).

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu sqarojme se mjete është i domosdoshem pasi nevojitet për të bërë të mundur levrimin e mallrave pranë Autoritetit Kontraktor.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent të vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatori ekonomik të jete i certifikuar për cilësinë të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Kjo certifikate lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

2.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë që plotëson specifikimet teknike për të gjithë artikujt/mallrat objekt prokurimi.
- b) Operatori ekonomik duhet të deklarojë se nëse shpallet fitues, mallrat do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponibilitet të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK.

2.6 Operatori ekonomik ditën e zhvillimit të tenderit duhet të paraqesë fizikisht mostrat për artikujt sipas tabelës si më poshte:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
4	Llambe led neoni T8 60cm 18w	cope	1
9	Kabell 4x6 (CU)	ml	1
10	Automat 4 polar 63A	cope	1
12	Kontaktor 4 polar 63 A	cope	1
19	Prozhektor led 100w 6400K	cope	1
22	Mufte 3 Fazore deri ne 500 w Ø32	cope	1
29	Kabell ABC 3 faze Ø16	ml	1
30	KABELL ABC MONOFAZE Ø16	ml	1
34	Konektor 3Faze.AL Ø32	ml	1

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambjentet e AK.
- Cdo moster e paraqitur pas orarit te percaktuar per hapjen e procedures nuk do te pranohet.
- Mostrat e kërkuara duhet detyrimisht të jenë të vulosura me vulën e ofertuesit, emrin e ofertuesit, datën e zhvillimit të tenderit, të nënshkruara në vende të dallueshme dhe të ketë numrin rendor korespondues me emrin e artikullit.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet teknike. Nese mostrat nuk jane sipas specifikimeve OE do te skualifikohet.
- Mosparaqitja e mostrave është kusht për s'kualifikim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6 “a”, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Udhezimit të APP-së Nr.3 datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë” Kriteri i vendosur për paraqitjen e mostrave është kërkuar për të vërtetuar lidhjen midis OE konkurrues në raport me mostrën e paraqitur ditën e hapjes së tenderit dhe dokumentacionit shoqëruar të paraqitur, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit. Gjithashtu për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike ku mostra e kërkuar do të shfaqë cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë gjithë zbatimit e kontrates.

Shënim: Kërkohet që OE në hapjen e ofertës të paraqes një produkt mostër duke u bazuar në rëndësinë që kanë këto produkte. Në tregun Shqipëtar dhe atë Botëror ekzistojnë disa tipe të ndryshme cilësish, fakt ky që na detyron për ti verifikuar paraprakisht produktet më të rëndësishme dhe për të qënë të sigurtë që ato do të jenë në cilësinë e duhur sipas specifikimeve të kërkuara, që mirëmbajtja e rrjetit elektrik të qytetit të jetë në nivelin më të mirë.

Shënim: Ne zbatim te pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i*

kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, **sjellim ne vemendje se:**

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t’i dergojë kerkese ne rruge elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit te kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do te jete kusht s’kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.
- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera gjate fazes se ofertimin. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike jane hartuar ne perputhje me nenin 36, te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **sipas shkresës Nr.5436 Prot, date 21.11.2023** (e cila eshte bashkëlidhur dosjes).

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Mallrat (materiallet elektrike) duhen sipas specifikimeve si më poshtë vijon:

- **Specifikimi për artikullin Transmator me fuqi 250W**

Nr	Emertimi	COSφ	Rryma (A)	Un	L	W	H	Frekuenca	Δt
		w/o PF		V	mm	mm	mm	Hz	°C

1	Transformator 250W	0.42	3	230 V	170 - 180	66 – 69	49 -53	50 Hz	70
---	-----------------------	------	---	-------	--------------	---------	--------	-------	----

- **Specifikimi për artikullin Llambe me fuqi 250 W.**

Nr	Emertimi	Fuqia W	Rryma A	Fluksi lm	Xokola	Diametr i Max	Gjatesi a Max	Ngjyr a K	Jetegjates ia
1	Llampe 250W	250	3	> 33000	E40	48	260	1900 - 2100	> 44,000

- **Specifikimi për artikullin Ndezes me fuqi 100 - 400 W.**

Nr	Emertimi	COSφ	Rryma (A)	Un	L	W	H	Frekuenca	Δt
		w/o PF		V	mm	mm	mm	Hz	°C
1	Injektore ndezes 100-400W		Max 5	4.5kV	86 - 96	36 - 48	32 - 42	60 Hz	60

- **Specifikimi për artikullin Llambe led neoni T8 60cm 18w.**

Nr	Emertimi	Fuqia W	Rryma A	Fluksi lm	Xokola	Diametr i Max	Gjatesi a Max	Ngjyr a K	Jetegjates ia
3	Llampe Neon T8 18W 60cm	18W		>5200	T8	28	120	4000- 4100	>15000

- **Specifikime per KABLLOT DHE PERCJELLESAT**

Kabllo prej bakri për rrjetin e ndriçimit duhet të plotësojnë këto karakteristika të përgjithshme teknike:

- Të jenë kablo multipolare me përcjellës fleksibël
- Përcjellësi të jetë bakër, fleksibël, i veshur
- Izolacioni të jetë përzierje gome etilpropilenik në temperaturë të lartë 90°C e cilësisë së lartë G16.

- Materiali mbushës të jetë jothithës i lagështirës, që nuk lejon ndezjen e shkëndijës.
- Karakteristikat teknike:

Tensioni nominal	0,6/1 KV
Tensioni maksimal	1200 V
Temperatura e punës	90° C
Temperatura në lidhje të shkurtër	250° C
Sforcimet maksimale per 1mm ² seksioni	50 N/mm ² percj. Cu
Rrezja minimale e përthyerjes kabllit	4 - fishi i diametrit të jashtëm
- Fusha e perdorimit: Kabëll për transmetim energjie, për montim në ambiente të jashtme të lagura, për vendosje në mure e struktura metalike si dhe për shtrim nën tokë.
- Të jenë të markuara me markat e cilësisë IMQ ose CE.

Percjellesat prej bakri për rrjetin e ndriçimit duhet të plotësojnë këto karakteristika të përgjithshme teknike:

- Percjelles për transmetim energjie elektrike, i izoluar.
- Percjellësi të jetë bakër, fleksibël, i veshur.
- Materiali mbushës të jetë jothithës i lagështirës, që nuk lejon ndezjen e shkëndijës.
- Karakteristikat teknike:

Tensioni nominal	450/750 V
Temperatura e punës	90° C
Temperatura në lidhje të shkurtër	250° C
- Të jenë të markuara me markat e cilësisë IMQ ose CE.
- Seksionet e percjellesave që kërkohen:
1.5 mm²/ 2.5 mm²/ 4.0 mm² / 6.0 mm²

• **Specifikime per AUTOMAT 4P**

Automatet 4 polarë me rrymë 32A, 40A, 63A, 100A, 150A, 250A duhet të kenë këto karakteristika:

Tipi magneto-termik

Normë e referimit **CEI EN 60898-1 ose SSH EN 60898-1; EN/IEC 60947-2 ose SSH EN/IEC 60947-2**

Versioni 4P

Karakteristika magneto-termike	C
Rrymat nominale ne 30°C	32A, 40A, 63A, 100A, 150A, 250A
Tensioni nominal	380V
Tensioni maksimal i punës	415V
Tensioni i izolacionit	500V
Frekuenca nominale	50-60 Hz
Fuqia nominale e shkëputjes së qarkut të shkurtër	10kA
Temperatura e punës	(-25°C) deri në 70°C
Numri maksimal i manovrave elektrike	10.000 cikle

Numri maksimal i manovrave mekanike 20.000 cikle
Grada e proteksionit IP20/ IP40
Seksioni maksimal i kabllimit 25-35mm²

- **Specifikime per KONTAKTOR 4P**

Kontaktoret duhet te jene katërpolare (40/63/80A) magneto-termik per rryma 32/40/65/80A.

Tipi LC1-D dhe RRL muzgu.

Bobina duhet 220VAC.

Norme Referimi **EN 60947-4-1/5-1 IEC 60947-4-1/5-1ose SSH EN/IEC 60947-4-1/5-1**

Cikle Operimi deri ne 2.000.000 cikle mekanike sipas standartit **EN/ISO 13849-1 ose SSH EN ISO 13849-1**

- **Specifikime për artikullin Kapuc:**

- Termialet kapuc mundesojne bashkimin e dy ose me shume percjellesave,me nje lidhje solide dhe izolim perfekt.Materiali: bakër/plastic, Tipi: Terminal, Seksioni: 32 mm, 25mm dhe 16 mm.

- **Specifikimi për artikullin Izolant:**

Te jete izolacion i mire, i forte, rezistent ndaj temperatures me paketim rrotull gjatesi 100 meter linear gjeresi 20 mm.

- **Specifikimi për artikullin Silikon:**

Silikon ngjites dhe mbushes universal transparent kristal te jete i prodhuar me teknologjine unike te Polymer.Te sherbeje per te ngjitur dhe mbushur praktikisht ne te gjitha llojet e materialeve.Paketimi: 300 g.

- **Specifikimi për artikullin Prozhektor LED 100 W, 6400K:**

Prozhektor LED 100 W, 8500lm, 6500K,IP65, gri.Tipi: Prozhektor led

Lloji i ndriçimit: 6500 K,Lartësia: H24.8 cm.Fluksi i ndriçimit: 8500 lm.Fuqia: 100 W.Materiali: Alumin. Përmasat: 3.1x29 cm.Ngjyra: Gri.Ndriçimi: LED

- **Specifikimi për artikullin Mufte 3 Fazore deri ne 500 w (Ø16, Ø25 dhe Ø32):**

Konstruksioni i mufteve duhet te rigjeneroj elektrikisht dhe mekanikisht konstruksionin e vet kabllit. Muftet e tensionit te ulet jane te perbera nga kater tuba te brendshem me termotkurje dhe nje te jashtem po me termotkurje . Bashkueset(gilzat me bulon) realizojne lidhjen elektrike te percjellesave. Koka e bulonit duhet te keputet kur arihet shtrengimi i duhur. Tubat izolues te brendshem duhet të jenë te veshur nga brenda me lëndë ngjitëse termo-tkurrëse, e cila, duke u shkrirë gjatë nxehtësisë, duhet të realizojë ngjitjen e veshjes izoluese me dejet e kabllit.Tubi i jashtem me termotkurje dhe ngjitje duhet të jetë i veshur nga brenda me lëndë ngjitëse termo-

tkurrëse, e cila, duke u shkrirë gjatë nxehtësisë, duhet të realizojë ngjitjen e veshjes izoluese me mbulesen e jashtme të kabllit. Muftë 3 Fazore deri në 500 W Ø16, Ø25 dhe Ø32.

- **Specifikimi për artikullin Muftë monofaze (Ø16, Ø25 dhe Ø32):**

Konstruksioni i muftëve duhet të rigjenerojë elektrikisht dhe mekanikisht konstruksionin e vet kabllit. Muftet e tensionit të ulët janë të perbera nga katër tuba të brendshëm me termotkurje dhe një të jashtëm po me termotkurje. Bashkueset (gizat me bulon) realizojnë lidhjen elektrike të përcjellesave. Koka e bulonit duhet të keputet kur arihet shtrengimi i duhur. Tubat izolues të brendshëm duhet të jenë të veshur nga brenda me lëndë ngjithëse termo-tkurrëse, e cila, duke u shkrirë gjatë nxehtësisë, duhet të realizojë ngjitjen e veshjes izoluese me dejet e kabllit. Tubi i jashtëm me termotkurje dhe ngjitje duhet të jetë i veshur nga brenda me lëndë ngjithëse termo-tkurrëse, e cila, duke u shkrirë gjatë nxehtësisë, duhet të realizojë ngjitjen e veshjes izoluese me mbulesen e jashtme të kabllit. Muftë monofaze Ø16, Ø25 dhe Ø32

- **Specifikimi për artikullin Kabell bakri 3 Fazë (Ø16, Ø25 dhe Ø32):**

Materiali është projektuar për të punuar në rrjet në kushte atmosferike të ndryshme pa u demtuar. Kablli duhet të rezistojë rezatimit UV. Kabllot duhet të kenë markim CE. Tensioni me I lartë në sistem kV 0.66

Tensioni nominal V 400/230. Tensioni nominal U_0/U kV 0,6/1kV

Numri i fazëve 3 fazë/ 4. përcjellesa. Frekuenca Hz 50. Materiali i përcjellesit Baker

Seksioni i përcjellesit mm² 4x10. Rezistenca në 20 °C Ohm/km 1.91

Rryma e lejuar për temperaturë të përcjellesit 70 °C A 55

Materiali i izolimit PVC. Mbulesa e jashtme PVC. Temperatura maksimale e punës °C 70

Ngjyra e mbulesës së jashtme E zeze. Frekuenca Hz 50. Kabell bakri 3 Fazë Ø16, Ø25 dhe Ø32.

- **Specifikimi për artikullin Kabell ABC 3 fazë (Ø16):**

Kabllot ajror duhet të projektohen konform standarteve IEC. Do të pranohen gjithashtu pajisjet, materialet ose puna që përkon me standardet ndërkombëtare të njohura që garantojnë cilësi të njëjtë ose më të lartë se standardet e specifikuar. Kablli me katër përcjelles dhe dy përcjelles, përbëhet nga përcjellës alumini të izoluar të cilët janë gërshetuar në formën e litarit dhe nuk kanë mbulesë të përbashkët. Çdo përcjellës përbëhet nga tela alumini të cilët janë gërshetuar në formën e litarit dhe janë të gjithë të izoluar me një mbulesë polietilene; kjo mbulesë përforcohet dhe testohet me një izolim të dyfishtë. Të gjithë këta përcjellës funksionojnë si një i vetëm, duke e shpërndarë sforcimin në të gjithë gjatësinë e tyre. Përcjellesit janë rezistent ndaj ujit dhe rrezatimit ultraviolet. Kablli duhet të rezistojë rezatimit U Temperatura maksimale e ambientit 40°C. Temperatura minimale e ambientit -10 °C. Lageshtia maksimale relative 80%

- **Specifikimi për artikullin Kabell ABC monofaze (Ø16 dhe Ø25):**

Kabllot ajror duhet të projektohen konform standarteve IEC. Do të pranohen gjithashtu pajisjet, materialet ose puna që përkon me standardet ndërkombëtare të njohura që garantojnë cilësi të

njëjtë ose më të lartë se standardet e specifikuara. Kablli me katër percjelles dhe dy percjelles, përbëhet nga përcjellësa alumini të izoluar të cilët janë gërshetuar në formën e litarit dhe nuk kanë mbulesë të përbashkët. Çdo përcjellës përbëhet nga tela alumini të cilët janë gërshetuar në formën e litarit dhe janë të gjithë të izoluar me një mbulesë polietileni; kjo mbulesë përfordhet dhe testohet me një izolim të dyfishtë. Të gjithë këta përcjellës funksionojnë si një i vetëm, duke e shpërndarë sforcimin në të gjithë gjatësinë e tyre. Përcjellësit janë rezistent ndaj ujit dhe rrezatimit ultraviolet. Kablli duhet të rezistojë rrezatimit UTemperatura maksimale e ambientit 40oC.Temperatura minimale e ambientit -10 oC.Lageshtia maksimale relative 80%.

- **Specifikimi për artikullin Konektor 3 FAZE AL (Ø16, Ø 25 dhe Ø32):**

Kjo nyje është projektuar për të realizuar lidhjen elektrike të linjes me percjelles alumini me vetembajtje(linja ABC) me percjellesa të cveshur (Al, Cu e tje).Rezistenca e kontaktit që realizohet duhet të jete në temperaturën 20 oC jo më i madh se 265 mikro Ohm, por jo më e madhe se 0.815 e vlerës së rezistencës së percjellesit. Gjithashtu ky shtrengim nuk duhet të zvogelojë qëndrueshmërinë mekanike të percjellsave.

Ndërsa pjesët paralele ku futet percjellesi i cveshur, gjatë shtrengimit të bullonit, levizin edhe ato diametralisht poshtë dhe lart njësoj si të morsetat e zakonshme që përdoren në percjellesat e cveshur duke realizuar një rezistencë kontakt me vlerat që u përmenden më lart . Në rastin kur përdoren për percjellesa Al, të dy pjesët e sipërmja dhe e poshtëmja janë të përbera prej aliazhi alumini me qëndrueshmëri të lartë. Në rastin kur përdoren për percjellesa Cu, ato janë përberë prej bakri të pastër elektrolitik .

- **Specifikimi për artikullin Konektor MONOFAZE (Ø16, Ø 25 dhe Ø32):**

Kjo nyje është projektuar për të realizuar lidhjen elektrike të linjes me percjelles alumini me vetembajtje(linja ABC) me percjellesa të cveshur (Al, Cu e tje).Rezistenca e kontaktit që realizohet duhet të jete në temperaturën 20 oC jo më i madh se 265 mikro Ohm, por jo më e madhe se 0.815 e vlerës së rezistencës së percjellesit. Gjithashtu ky shtrengim nuk duhet të zvogelojë qëndrueshmërinë mekanike të percjellsave.

Ndërsa pjesët paralele ku futet percjellesi i cveshur, gjatë shtrengimit të bullonit, levizin edhe ato diametralisht poshtë dhe lart njësoj si të morsetat e zakonshme që përdoren në percjellesat e cveshur duke realizuar një rezistencë kontakt me vlerat që u përmenden më lart . Në rastin kur përdoren për percjellesa Al, të dy pjesët e sipërmja dhe e poshtëmja janë të përbera prej aliazhi alumini me qëndrueshmëri të lartë. Në rastin kur përdoren për percjellesa Cu, ato janë përberë prej bakri të pastër elektrolitik .

- **Specifikimi për artikullin PRIZA:**

Priza të jenë cilësore dhe të jenë brand ,ngjyre e bardhe dhe e zeze,me dy module,me tension 230-230v,materiali plastik baker.Prizat të jenë të shoqëruara me bashkë me shuko.

- **Specifikimi për artikullin Celsa:**

Çeles per piza bipolare,monofaze me ngjyre te bardhe.

- **Specifikimi për artikullin Sinjalizues:**

Sinjalizuesi i cili vendoset ne automat dhe trgon rrymat per tension 220-230 v.te jete cilesor prodhim eu.

Shenim: Nese mallrat nuk jane sipas specifikimeve te mesiperme komisioni nuk do ti mare ne dorezim.

Afatet e lëvrim: Brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e kësaj procedure, Njësia e Prokurimit autorizon përsonein përgjegjës për prokurimin.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT:

1. Pjeter Bushi Kryetar (Përsoni përgjegjës)
2. Elvis Guraj Anëtar
3. Rudolf Toma Anëtar